LIGJ
Nr.7751, datë 14.9.1993

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ZHVILLIMIT PËR ASISTENCË TEKNIKE PËR REFORMËN EKONOMIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS SË ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR (IDA)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të ratifikojë marrëveshjen e kredisë së zhvillimit për projektin e asistencës teknike për reformën ekonomike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Zhvillimit Ndërkombëtar (IDA), për dhënien Republikës së Shqipërisë të një kredie prej 2.9 milionë SDR (4.6 milionë USD), nënshkruar në Uashington më 7 qershor 1993.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.649, datë 24.9.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.